

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-vendim : “Konsultim publikë me grupet e interesit për konsultimin e planit të veprimit për Përshtatshmërinë ndaj Ndryshimeve Klimatike (mbeshtetur nga UNDP-ja)

Propozuesi : Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak

Sqarime për projekt-aktin : Informim i grupeve të interesit publik të Bashkisë Elbasan mbi dokumentin strategjike për Elbasanin me vlerë të shtuar në menaxhimin e ndryshimeve klimatike

Qëllimi i këtij konsultimi është të mblidhen sugjerimet e komunitetit lidhur me:

- Vizioni ynë i përbashkët, qëllimet dhe objektivat;
- Performancën e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe lobimi për thithje fondesh tek ministritë e linjës dhe donatorët kombëtarë dhe nderkombëtarë.
- Shërbimet prioritare të komunitetit.

Kalendari i konsultimit: Konsultimet do të realizohen me datë **17 Shkurt 2025**

Pjesëmarrës :

- **Nga ana e Bashkisë :** Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Territorit Urban, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të ardhurave , Aseteve Buxhetit dhe Financës, Agjencia e Pyjeve, Agjencia e Trashëgimisë Kulturore, koordinatori për informim dhe konsultim, Drejtoria e Integritimit Europian Projekteve dhe Donatoreve, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të Sekretariatit të Këshillit Bashkiak.
- **Nga komuniteti:** përfaqësues të bizneseve; përfaqësues të organizatave Jofimprurëse, përfaqësues të Këshillit Rinor; përfaqësues të Qendrës së Formimit Profesional; akademikë dhe studentë të Universitetit “A,Xhuvani” ; përfaqësues të komunitetit të gjashtë lagjeve dhe dymbëdhjetë njësi administrative të Bashkisë Elbasan, ekspertë lokal etj.
- **Format e konsultimit:** Takime të hapura publike, organizuar më datë **17 Shkurt 2025**

Gjithashtu mund të merrni pjesë duke u bërë pjesë e sugjerimeve dhe rekomandimeve edhe nepermjet emailit: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al, gledianllatja@elbasani.gov.al ose lutfilala@yahoo.com

<p>Qëllimi i këshillimit publik</p>	<p>Këshillimi publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve, biznesit, shoqërisë civile, kryetarëve të fshatrave, strukturave komunitare në lidhje me përmirësimin e draft-planit të veprimit për Përshtatshmerinë ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion mbi mendimin e komunitetit për identifikimin, vlerësimin, monitorimin e prioritetëve që lidhen me eficienten e energjisë dhe ndryshimeve klimatike.</p> <p>Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit, do t'i shërbejë Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për të përcaktuar se si do të arrihe vizionin tonë të përbashkët në uljen e emetimeve sere, dekarbonizimin me të pakten 40% me pak deri në vitin 2030, sipas udhëzimeve të dhëna edhe nga Bashkimi Evropian.</p> <p>Koheshtrirja e dy planeve strategjike është 2024-2030.</p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-vendimi</p>	<p>Miratimi i planit të veprimit për Përshtatshmerinë ndaj ndryshimeve klimatike është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren në përputhshmëri me plotësimin e masave strategjike të planifikuara në këtë plan veprimi.</p>
<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p>Këshilli i Bashkisë ka marrë draft planin ndaj ndryshimeve klimatike, sikurse do të monitorojë edhe konsultimin publik të tyre.</p> <p>Bazuar në Ligjin 139/2015 Neni 17, ka vendosur kalimin në konsultim publik të planit strategjik sipas metodologjisë së përcaktuar nga baza ligjore.</p>
<p>Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;</p>	<p>Bashkia Elbasan në bashkëpunim me Këshilli e Bashkisë do të organizojnë konsultimin publik me date: 17 Shkurt 2025, ora 10:00, në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla multifunksionale. Ky takim do të organizohet nën pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve lokal. Grupet e interesit publik ftohen të marrin pjesë sikurse ata që e kanë të pamundur pjesëmarrjen janë të lutur të dergojnë sugjerimet e tyre me email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al.</p>

<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet pjesmarrjes suaj në takimet publik, por në pamundësi për të marrë pjesë në këtë konsultim do të na ndihmoni duke dhënë sugjerimet pranë zyrave me një ndalesë në çdo lagje dhe njësi administrative të Bashkisë Elbasan, si dhe duke kontaktuar me përfaqësuesin e komunitetit si dhe mund të dërgohen në adresën e emailit të kryetarit të Bashkisë Elbasan me email: gledianllatja@elbasani.gov.al dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak me email: lutfilala@yahoo.com, ose të dërgohen me postë BRENDA DATËS: 17 Shkurt ne adresen: Bashkia Elbasan, rruga: Qemal Stafa.</p>
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p>	<p>Opsionet e mundëshme për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit: Ndryshime në prioritizimin e nevojave për nderhyrje me plan masash me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.</p>
<p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet</p>	<p>Plani Strategjik ndaj Ndryshimeve Klimatike (2025-2030) gjendet në faqen e Bashkisë Elbasan.</p>

<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerë Bashkia Elbasan sëbashku me Këshillin për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Bashkia Elbasan dhe Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtja e procesverbalit të takimit publik dhe bërja publike e tyre. 2. Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike. 3. Realizimin dhe përmbledhje të rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje. 4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari. 5. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës 6. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor. 7. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre.
<p>Data e publikimit</p>	<p>29 Janar 2025</p>
<p>Përgjegjës:</p>	<p>Spektori i konsultimit publik sëbashku me koordinatoren për konsultim dhe me drejtorinë e Inovacionit dhe Medias, pranë Bashkisë Elbasan.</p>